

AKTI I THEMELIMIT

I

"LH Group" sh.p.k

Në Tiranë sot me datë 07.11.2025 Z.Engjell Limani, shtetas shqiptar lindur më 29.12.2000, mbajtës i mjetit të identifikimit Letërnjoftim me numër 039102764, dhe me numër personal K01229069B, person madhor me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar. Me vullnet të lirë e të plotë, si themelues i vetëm i kësaj shoqërie dhe duke u bazuar në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (ndryshuar) si dhe cdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë vendos që të hartojë Aktin e Themelimit të Shoqërisë.

Neni 1

EMËRTIMI, STATUSI LIGJOR, KOHËZGJATJA

- 1.1 Emri i kësaj shoqërie tregtare do të jetë "LH Group sh.p.k",
- 1.2 Kjo Shoqëri Tregtare do të ketë statusin e personit juridik në formën e sh.p.k, i cili do të rregullohet sipas ligjit dhe të drejtës shqiptare, ka pavarësinë e tij ekonomike dhe administrative dhe do të funksionojë si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me Statutin e saj dhe duke u referuar sipas legjislacionin shqiptar përkatës.
- 1.3 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë tregtare si sh.p.k. do të jetë me një afat të pa caktuar.

Neni 2

SELIA

- 2.1 Selia e "LH Group sh.p.k" ndodhet në adresën: Rruga "Bill Klinton", Njësia Administrative Tiranë-Farkë, Tiranë, Republika e Shqipërisë.
- 2.2 "LH Group Fredi" sh.p.k ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e tij në të gjithë territorin e republikës së Shqipërisë.

Neni 3

OBJEKTI

- 3.1. Shoqëria "LH Group sh.p.k" do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

7311 – Agjencitë për publicitet

6201 – Aktivitetet e programimit kompjuterik



6202 – Aktivitetet e këshillimeve kompjuterike
 6203 – Aktivitete të menaxhimit të instalimeve kompjuterike
 6209 – Teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike
 6311 – Përpunimi i të dhënave, hostimi i informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to
 6312 – Web portalet
 7410 – Aktivitetet e specializuara të dizajnit
 4791 – Tregtia me pakicë në internet (e-commerce)
 4651 – Tregtia me shumicë e pajisjeve elektronike, telekomunikimit dhe pjesëve të tyre
 5829 – Publikimi i softuerëve të tjerë
 6110 – Aktivitetet e telekomunikimit kabllor
 6120 – Aktivitetet e telekomunikimit pa tela (wireless)
 7022 – Këshillime për menaxhim dhe zhvillim biznesit
 7990 – Shërbime ndihmëse të turizmit
 8559 – Akademi dhe kurse për njerëz
 9511 – Riparimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike.

Neni 4

KAPITALI THEMELOR

- 4.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 Lekë (dhjetë mijë) dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme: Kapitali themeltar ndahet në 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë me 10,000 (dhjetë mijë) Lekë kuota.
- 4.2 Ortaku i vetëm themelues i kësaj shoqërie do të jetë Z. Engjell Limani, shtetas shqiptar lindur më 29.12.2000, mbajtës i mjetit të identifikimit Letërnjoftim me numër 039102764 dhe me numër personal: K01229069B, person madhor me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar dhe zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale të barabartë me 10,000 (dhjetë mijë) Lekë kuota.

Neni 5

ORGANI VENDIMARRËS

- 5.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 5.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 5.3 Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;

- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - h) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) Shperndarjen e fitimeve vjetore.
 - n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 5.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e ortakëve, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme, përveçse në rastin kur ai është dhe ortaku i vetëm i Kompanisë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 6

ADMINISTRIMI

- 6.1 Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- 6.2 Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje.
- 6.3 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i vetëm i shoqërisë për një mandat 5 (PESË) vjeçar me të drejtë ripërtëritje :
- Emërohet: Z.Engjell Limani lindur më 29.12.2000, me shtetësi Shqiptare, mbajtës Leternjoftimit me numer 039102764 dhe me numër personal K01229069B me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 7

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

- 7.1 Çështjet të cilat nuk janë parashikuar në këtë akt, do të rregullohen në përputhje me dhe në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit si dhe dhe cdo dispozitë tjetër ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- 7.2 Z.Engjell Limani lindur më 29.12.2000, me shtetësi Shqiptare, mbajtës Leternjoftimit me numer 039102764 dhe me numër personal K01229069B me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, autorizohet si përfaqësues për të kryer të gjitha veprimet juridike në lidhje me shoqërinë si të ndjekë procedurat e nevojshme për themelimin dhe regjistrimin e Shoqërisë "LH Group sh.p.k" në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë por jo kufizuar në përgatitjen, rishikimin, ndryshimin, nënshkrimin, rregjistrimin dhe depozitimin e dokumentave përkatëse, aplikimeve dhe kërkesave në të gjitha institucionet shtetërore dhe private në Shqipëri, përfshirë por jo kufizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, organet tatimore, zyrat e punës, sigurimet shoqërore si dhe çdo ent, institucion, person juridik apo fizik.
- 7.3 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe me ligjin shqiptar. Ky Akt Themelimi u hartua në 2 kopje origjinale dhe pasi u lexua, u kuptua ky akt themelimi u nënshkrua nga themeluesi i vetëm si vijon.

THEMELUESI I VETËM

Z.Engjell Limani


Engjell Limani